

VENDIM
Nr. 85, datë 31.1.2020

PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE VAQARR , BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË
TIRANË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve “iii” e “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13 dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 1, Njësia Administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim.

2. Caktimin e Bashkisë Tiranë për këtë zonë, si njësi zbatuese, për:

- a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;
- b) ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës publike e kritike;
- c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;
- ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Pika	Koord_X	Koord_Y
1	394671.33	4572735.51
2	394672.92	4572757.00
3	394683.88	4572842.57
4	394562.43	4572884.63
5	394659.27	4572956.87
6	394712.45	4572893.63
7	394726.74	4572903.69
8	394736.53	4572900.51
9	394788.12	4572957.40
10	394811.93	4572953.96
11	394819.08	4572908.18
12	394792.09	4572804.73
13	394729.38	4572826.16
14	394720.92	4572798.86
15	394738.91	4572793.78
16	394732.45	4572775.02
17	394726.57	4572777.04
18	394707.25	4572723.61
19	394694.21	4572728.23
20	394671.33	4572735.51

